

Zyrat komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK) 2018


Zyrat komunale për komunitete dhe kthim janë të detyrueshme për të gjitha komunat dhe kanë mandat që t'i mbrojnë të drejtat e komuniteteve, të sigurojnë qasje të barabartë në shërbime dhe krijojnë kushte për kthim të qëndrueshëm. ZKKK-të i raportojnë drejtpërsëdrejti kryetarit të komunës, ndërsa madhësia e zyrës dhe numri i pozitave të punonjësve përcaktohet varësisht nga përqindja dhe nevojat e komuniteteve që banojnë në komunë, si dhe numri i planifikuar apo i pritur i të kthyerve apo personave të riatdhesuar. Që nga fillimet e tyre në vitin 2010, ZKKK-të janë themeluar zyrtarisht në 35 komuna. Dokumentet kryesore që rregullojnë krijimin dhe mandatin e ZKKK-ve janë Rregullorja 02/2010 për zyrat komunale për komunitete dhe kthim dhe Termat e referencës për ZKKK - Procedurat standarde të veprimit.

Themelimi


Që nga fillimet e tyre në vitin 2010, ZKKK-të janë themeluar në 35 komuna. Në Leposaviq, Mitrovicë Veriore dhe Zubin Potok janë krijuar zyra të tjera, të cilat *de facto* funksionojnë si ZKKK.

Funksionimi & Raportimi


ZKKK-të me plane të punës në vitin 2018




ZKKK-të që kanë dorëzuar raporte vjetore në vitin 2018



Përbërja gjinore e ZKKK-ve sipas komunitetit



Personeli i ZKKK sipas komunitetit




Performanca në vitin 2018


Numri i ZKKK-ve që i realizojnë detyrat themelore*

(Bazuar në monitorimet e rregullta të ekipeve në terren të OSBE-së dhe shqyrtimeve periodike specifike nga ekipet në terren, si edhe raportet e nxjerra nga komunat)

Vendosja e kontakteve me të gjitha komunitetet dhe kategoritë e përfituesve (p.sh. të kthyerit, personat e riatdhesuar ose rastet sociale nga radhët e komuniteteve)




Vlerësimi i të drejtave të komuniteteve/nevojave të përfituesve (ose azhurnimi i vlerësimit të mëparshëm)




Bashkërendimi dhe bashkëpunimi me akterët përkatës (p.sh. me OJQ, donatorë dhe përfitues)


*Mamushë nuk është përfshirë pasi nuk ka OJQ aktive në komunë




Përpilimi, monitorimi ose vlerësimi i projekteve në dobi të komuniteteve




Lehtësimi i mundësive për pjesëmarrjen e komuniteteve në hartimin e strategjive/politikave/planeve të veprimit




Monitorimi i politikave përkatëse për mbrojtjen/promovimin e të drejtave të komunitetit ose përfituesve të veçantë



Dhënia e këshillave (me shkrim ose verbalisht) për kuvendin e komunës ose organet ekzekutive komunale për çështje që lidhen me mbrojtjen/promovimin e të drejtave të komuniteteve




Komunikimi me publikun ose vetëdijesimi i komuniteteve dhe grupeve specifike të përfituesve



*Detyra të përcaktuara me kuadrin ligjor dhe të politikave që monitorohen rregullisht nga OSBE

Numri i detyrave themelore të realizuara



*Komuna e Junikut nuk bën pjesë në vlerësim pasi është njëetnike dhe nuk ka pranuar persona të riatdhesuar ose të kthyer gjatë periudhës raportuese.

Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSCE) ofron mbështetje për përmirësimin e pjesëmarrjes së komuniteteve në proceset e vendimmarrjes e qeverisjes si dhe në institucione. Në suazat e këtyre përpjekjeve, OSBE-ja e monitoron rregullisht punën e mekanizmave komunalë për mbrojtjen e komuniteteve. Këto fletushka informuese kanë si qëllim t'u ofrojnë akterëve përkatës komunalë dhe institucioneve të nivelit qendror tregues që mund t'u ndihmojnë për t'i identifikuar mangësitë në respektimin e kriterëve ligjorë.